



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 janar 2023
Nr. ref.:RK 2105/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI73/22

Parashtrues

N.T “Viva Pharmacie”

Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme ARJ.nr.133/21 të 29 dhjetorit 2021

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.T “Viva Pharmacie”, e cila përfaqësohet nga Aziz Haxhiu pronar nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.133/21] të 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [AA.nr.544/21] të 7 tetorit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A.nr.772/16] të 2 marsit 2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar [ARJ.nr.133/21] të 29 dhjetorit 2021 e ka pranuar më 27 janar 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22(Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

6. Më 25 maj 2022, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në postë kërkesën e saj, e cila arriti dhe u regjistrua më 31 maj 2022 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 8 qershor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes vendimit [Nr.GJR.KI73/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Remzie Istrefi Peci, anëtarë.
8. Më 10 qershor 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueses për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që ta sjellë kopjen e Aktgjykimit [ARJ.nr.133/21] të 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme . Po ashtu një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 10 qershor 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe nga ajo kërkoi që ta sjellë fletkthesën e cila tregon se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
10. Më 20 qershor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
11. Më 28 qershor 2022, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
12. Më 5 shtator 2022, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta sjell autorizimin për përfaqësim.

13. Më 23 shtator 2022, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin.
14. Më 13 dhjetor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Bazuar në shkresat e lëndës, Inspektorët tatimor pasi që kishin inspektuar parashtruesen e kërkesës dhe atë për periudhën 2010 -2014, përmes Njoftimit të rivlerësimit të 20 tetorit 2015, parashtruesen e kërkesës e kishin ngarkuar me tatim shtesë.
16. Parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës – Departamentin e Ankesave (në tekstin e mëtejme: ATK) kundër Raportit të kontrollit të Inspektoratit tatimor.
17. Më 21 prill 2016, ATK përmes vendimit [60/2016] e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, dhe kishte vërtetuar Njoftim rivlerësimit pas kontrollit si të bazuar.
18. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës kishte ushtruar padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore kundër vendimit [60/2016] të ATK-së, ku kishte kërkuar që të anulohet vendimi në fjalë si dhe vlerësimi nga inspektorët tatimor.
19. Më 2 mars 2021, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A.nr.772/16] refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar, dhe la në fuqi vendimin [60/2016] të 21 prillit 2016 të ATK-së.
20. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës përmes përfaqësuesit të saj paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e tij dhe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet në tërësi, në atë mënyrë që të aprovohet padia si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës nr.60/2016, ose aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet gjykatës së shkalës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.
21. Më 7 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.544/2021] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore e vërtetoi.
22. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që aktgjykimet e kontestuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
23. Më 29 dhjetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.133/2021] refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [ARJ.nr.133/2021] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
25. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës duke theksuar se Gjykatat e rregullta me theks të veçantë Gjykata Supreme nuk i kishte marrë për bazë pretendimet e saj, pasi që vendimin e kishte bazuar në vlerësimet e nxjerra nga ekspertiza financiare e punuar nga eksperti R.F, ku lidhur me këtë thekson se “*Gjykata ia ka falur besimin në tërësi kësaj ekspertize dhe vendimin e ka bazuar në të njëjtën pavarësisht faktit se paditësi i ka paraqitur edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të gjitha vërejtjet e tij lidhur me ekspertizën e punuar nga eksperti financiar. Pavarësisht faktit që nga ekspertiza shihet qarte se mendimi dhe konstatimi është jo profesional dhe jo i pavarur serish gjykata ka vendosur krejtësisht sipas ekspertizës. Kjo ekspertize është e përgjithësuar dhe e pabazuar në ligjet dhe dispozitat e aplikueshme për procedurat tatimore. Gjykata e as eksperti me rastin e përpilimit të ekspertizës nuk e ka marrë parasysh faktin se e paditura ATK me rastin e llogaritjes së stogëve, KMSH-se dhe për fitimin bruto është dashur që të merret komplet vitin dhe jo vetëm pjesa e datës 31.07.2010. Kjo për arsye se tatimi në fitim duhet të llogaritet për tërë vitin gjithashtu KMSH-ja e sidomos marzha nuk mund të llogaritet vetëm për këtë periudhë pasi që për periudhën pas datës 31.07.2010 ka pasur shitje edhe të mallrave të blera para kësaj date, të cilat kanë qene në stogë. Edhe pse nga raporti i kontrollit nuk është e qarte se nga e ka marrë dhe si e ka llogaritur marzhën e shitjes, megjithatë pikërisht duke u mbështetur në llogaritjen e marzhës së përdorur nga ana e inspektorit të ATK-se, por duke e shtrire në tërë vitin na del një diferencë tjetër për vitin 2010 përkatësisht jo shuma prej 92,000.74 € por 78,470.41 €. Ndërsa eksperti me ekspertizë ka vazhduar me të njëjtin konstatim si në vendimin e të paditurës, duke mos e llogaritur drejtë marzhën. Kështu i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 39 të ligjit Nr.05/L-037 paragrafi 4 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në të cilën theksohet se "Proporcioni i zbritshëm i TVSH-se duhet të përcaktohet në baza vjetore si përqindje dhe duhet të rrumbullakohet në një numër të plotë që pason "*
26. Tutje parashtruesja e kërkesës pretendon se përlllogaritja e tatimit nga ana e inspektoratit të ATK-së ka qenë e gabuar, pasi që siç thekson “... në vitet të cilat inspektorati ka llogaritur të hyrat e raportuara nga ana jonë kanë qenë më të ulëta se sa të hyrat që i ka konstatuar inspektori i ATK-së në bazë të kësaj metodologjie, inspektori ka llogaritur nën deklaram dhe ka caktuar tatim shtesë, tatim në fitim dhe tatim mbi vlerën e shtuar. Mirëpo, në vitet në të cilat ka llogaritur që të hyrat e raportuara nga ana e jonë kanë qenë më të larta se sa të hyrat që i ka konstatuar inspektori i ATK-se në baze të kësaj metodologjie (siç; është rasti në 2012 dhe 2014), inspektori nuk ka llogaritur asgjë dhe ka pranuar deklaramin e tatimeve nga ana e kompanisë. Kështu Inspektorati Tatimor ka bërë disa devijime nga Ligjet dhe Rregulloret mbi Vlerësimin konform nenit 19 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Sqarojmë se arsyeja e Kontrollit si "Analize e Riskut" dhe rezultatet e tatimit shtesë nuk përputhet me të gjeturat e Raportit të Kontrollit. Konstatimi i inspektoreve me rastin e kontrollit ishin se: Tatimpaguesi Posedon Librat Afariste, Libër Blerje dhe Libër shitje, ka të punësuar dhe lajmëruar 3-4 punëtor, në të gjitha pikat posedon Arkat Fiskale si obligimi ligjor, dhe se ka deklaruar tatimet për të gjitha periudhat është në harmoni me kërkesat për regjistrime sipas nenit 13 të Ligjit 03/L-222, konstatim i cili është krejtësisht i kundërt me vendimin përfundimtar të marrë nga i njëjti. Kështu, shihet që edhe vendimi i të paditurës është marrë me shkelje nga nenit 19 i të njëjtit ligj 03/L-222”.
27. Parashtruesja e kërkesës më tej pretendon se Gjykata ka bërë shkelje të nenit 160 par.5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), pasi që siç

thekson ajo "kishte kërkuar nga gjykata nxjerrjen e një super ekspertize për analizimin e kësaj çështje, mirëpo gjykata përveç; qe këtë kërkesë e ka refuzuar e njëjta as nuk e ka arsyetuar se pse ose mbi çfarë baze ligjore e ka refuzuar këtë kërkesë te paditësit".

28. Më tej parashtruesja e kërkesës pohon se pasi që nuk ishte pajtuar me mendimin e ekspertizës të cilën gjykata e kishte njohur, ajo kishte angazhuar një ekspert të pavarur i cili kishte dhënë mendimin dhe konstatimin për këtë çështje, ku sipas saj eksperti kishte vërtetuar se "ekspertiza te cilës gjykata ia ka falur besimin është e pabazuar ne dispozita ligjore dhe me te gabimisht është konstatuar gjendja faktike. Nga kjo ekspertize Gjykata dhe eksperti i angazhuara nga ana i gjykatës fare nuk e kane marr për baze 23 fatura te cilat ndikojnë ne llogaritjen e tatimit e qe kane te bëjnë me te njëjtën barnatore prej te ditës kane kërkuar pagesën e tatimit shtese. Po ashtu gjykata dhe eksperti financiar nuk i ka llogaritur si shpenzime vlerat e paguara për licencat e barnatores ku ka ushtruar kontroll si dhe faturat për pagesat e shfrytëzimit te arkës fiskale, të të njëjtës barnatore. Kështu, referuar te larte cekurave shohim qe te dy gjykatat kane arritur në një përfundim krejtësisht duke u bazuar ne një ekspertize te pasakte dhe jo analizuese për çështjen konkrete, pa i analizuar ne mënyrë të përfillte faktet e prezantuara dhe dispozitat ligjore te cilat e rregullojnë këtë çështje tatimore andaj dhe këto vendime janë marr me shkelje te dispozita ligjore".
29. Në fund parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës; (iii) të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme ARJ.nr.133/21 të 29 dhjetorit 2021; dhe (iv) të kthejë lëndën në rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

[...]

LIGJI Nr. 04/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT Nr. 03/L-222

Neni 81.F

Detyrimi i vërtetimit

1. Tatimpaguesi do të bartë detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj.

2. Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bartë detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit.

3. Provat e mbledhura nga procedurat penale tatimore dhe doganore dhe vendimi i gjykatës penal, mund të përdoret në procesin gjyqësor para Divizionit Fiskal, mbi bazën e identifikimit të fakteve dhe personave.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

32. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”

33. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridik (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, me parashtrues “Bayerische Versicherungsverband”, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

34. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”.

35. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës: është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ajo e konteston kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.133/21] e 29 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

36. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nën rregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

37. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastet e Gjykatës KI04/21, me parashtruese Nexhmije Makolli, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe KI175/20, me parashtrues: Agjencia Kosovare e Privatizimit, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të

fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GjEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës *KI166/20*, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime "konfuze dhe të paqarta" (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Kemmache kundër Francës*, nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), *Juta Mentzen kundër Lituanisë*, nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii).

39. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimi nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin *KIO4/21*, cituar më lart, paragrafi 28).
40. Rrethanat e rastit konkret, ndërlidhen me atë që parashtruesja e kërkesës pas inspektimit të Inspektoratit tatimor, ishte ngarkuar me tatime shtesë. Parashtruesja e kërkesës ishte ankuar në Komisionin e ankesave të ATK-së, lidhur me raportin e vlerësimit të Inspektoratit tatimor. Komisioni i ankesave i ATK-së e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës dhe kishte vërtetuar vlerësimin e Inspektoratit tatimor. Parashtruesja e kërkesës kishte ushtruar padi në Gjykatën Themelore kundër vendimit të ATK-së, të cilën padi Gjykata Themelore e kishte refuzuar dhe kishte lënë në fuqi vendimin e ATK-së. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër vendimit të Gjykatës Themelore, e cila ankesë ishte refuzuar. Në Gjykatën Supreme parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, por e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme.
41. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

i) Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

42. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës qëndron në pretendimin se Gjykata Supreme ka shkelur nenin 31 të Kushtetutës, pasi që vendimin e saj e kishte bazuar në ekspertizën me të cilën ai nuk ishte pajtuar, duke arsyetuar "... Gjykata ia ka falur besimin në tërësi kësaj ekspertize dhe vendimin e ka bazuar në të njëjtën pavarësisht faktit se paditësi i ka paraqitur edhe në seancën e shqyrtimit kryesor të gjitha vërejtjet e tij lidhur me ekspertizën e punuar nga eksperti financiar. Pavarësisht faktit që nga ekspertiza shihet qarte se mendimi dhe konstatimi është jo profesional dhe jo i pavarur serish gjykata ka vendosur krejtësisht sipas ekspertizës.

Kjo ekspertizë është e përgjithësuar dhe e pabazuar në ligjet dhe dispozitat e aplikueshme për procedurat tatimore”.

43. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e gabuar të ligjeve të zbatueshme nga Gjykatat e rregullta, përkatësisht nenit 19 të Ligjit 03/L-222 për ATK-në dhe Procedurat, si dhe nenit 160 paragrafi 5 i LPK-së.
44. Në lidhje me këtë, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe karakteristikat e saj, siç përcaktohen në KEDNJ, si dhe parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar ndryshimin midis “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin e gabuar dhe zbatimin e gabuar të ligjeve, që pretendohet të jenë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla kanë mundur të shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyza Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
45. Gjykata gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se nuk mund të vlerësojë vetë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
46. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar se në bazë të cilave prova dhe në bazë të të cilave dispozita materiale kanë nxjerrë aktgjykimet përkatëse, duke iu përgjigjur pretendimeve të parashtrueses së kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
47. Së pari, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A.nr.772/16], refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar dhe la në fuqi vendimin nr.60/2016 të 21 prillit 2016 të ATK-së, me arsyetimin se “[...] Gjykata konsideron se përdorimi i mjeteve dhe metodave të provuarit, nënkupton një detyrim për palët dhe respektimin e procedurave ligjore të përcaktuara me ligj, rrjedhimisht në këtë kuptim gjykata vlerëson se paditësi nuk ka arritur të mbështes me prova pretendimet e tij në padi ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 81.F par. 1 të Ligjit nr. 04/L-102, pasi që në bazë të kësaj dispozite “Tatimpaguesi do të bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij/saj”. Ndërsa neni 7 par.1 dhe 3 i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: “palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”. Andaj nga kjo rezulton se gjykata i ka dhënë mundësi paditësit nxjerrjen e provës përmes ekspertit financiar i cili në

ekspertizën financiare ka konstatuar se ekzistojnë konstatimet e gjetura për periudhën kontestuese të kontrollit sipas Raportit të Kontrollit. Nga kjo gjendje gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative. Për arsye se, pretendimet e fakteve në këtë rast bien në barrë të paditësit i cili në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin të kundërtën e nga vendimi kontestues. Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat i kemi elaboruar me lartë, paditësi nuk ka mundur të argumentojë me prova bindëse, një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura, ndërsa provat tjera të paraqitura nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje administrative. Pas analizës dhe vlerësimit të gjendjes faktike, Gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dem të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata vlerëson se vendimi kontestues i ATK-së është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë".

48. Po ashtu edhe Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.544/2021] refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ku ndër të tjera theksoi "[...] Gjykata e shkallës së parë i ka dhënë mundësi paditësit nxjerrjen e provës përmes ekspertizës financiare, i cili në ekspertizën financiare ka konstatuar se ekzistojnë konstatimet e gjetura për periudhën kontestuese të kontrollit sipas Raportit të Kontrollit. Prandaj, nga kjo gjendje gjykata e shkallës së parë me të drejte nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se pretendimet e fakteve në këtë rast bien në barrë të paditësit i cili në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin të kundërtën e konstatimeve nga vendimi kontestues. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA-së, dhe Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat".
49. Në fund, në lidhje me pretendimet e parashtrueses së kërkesës vendosi edhe Gjykata Supreme, e cila e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në tërësi. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit [ARJ.nr.133/2021], ndër të tjera arsyetoi "[...] mbi këtë gjendje Gjykata Supreme vlerëson se, gjykatat e instancave më të ulëta dhe organi administrativ i paditur si në vendimin e tij përfundimtar, drejtë kanë zbatuar dispozitat e LPA-së, LKA-së, të LPK-së, (ligji i zbatueshëm si në kuptim të nenit 63 të LKA-së) si dhe të ligjit material për ATK-në dhe procedurat. Aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj janë të pa qëndrueshme pretendimet në kërkesë. Kolegji po ashtu vlerëson se në këtë çështje edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe organi i paditur dhe nuk është cenuar ligji në dem të paditësit [...]".
50. Prandaj, Gjykata konstaton që parashtruesja e kërkesës ka pasur mundësi të përfitojë nga procedura kontradiktore dhe se ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e saj; ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar

objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, dhe për këtë arsye procedura, e marrë në tërësi, ishte e drejtë (shih *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI22/19, parashtrues Sabit Ilazi, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).

51. Gjykata thekson që në rrethanat e rastit konkret, parashtruesja e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, thekson se, Gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht dispozitën e nenit 19 të Ligjit 03/L-222 për ATK-në, si dhe nenit 160 paragrafi 5 i LPK-së, megjithatë ajo nuk e mbështet në asnjë mënyrë dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesen e kërkesës apo se si procedurat pranë gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe kanë arsyetuar qartazi të njëjtat (Shih rastet e Gjykatës KI64/20, parashtrues Asllan Meka, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41; dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
52. Thënë këtë Gjykata vlerëson se Gjykatat e rregullta arsyetuan në mënyrë të detajuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës, ku në bazë të provave të nxjerra ishte vërtetuar se nuk qëndrojnë pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe me këtë rast, të njëjtat ishin shpallur si të pa bazuara. Sa më sipër, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur që pretendimet e saj për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë t'i ngrejë në nivel kushtetutshmërie.
53. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së janë (i) pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtrueses së kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 dhjetor 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani